

Skenderbe Sadikaj
REFORMA NË DREJTËSI, VETINGU DHE RIORGANIZIMI I DREJTËSISË NË
REPUBLIKËN E KOSOVËS

Abstrakti

Funksionimi i drejtësisë është parakushti kryesor për krijimin e shtetit ligjor në të cilin respektohen të drejtat dhe liritë e të gjithë qytetarëve. Shoqëritë demokratike synojnë të ndërtojnë sisteme funksionale të cilat kujdesen për ruajtjen e rendit dhe ligjit, sigurojnë zbatimin e plotë dhe të paanshëm të ligjit dhe atë për të gjithë njësoj, përmes parimit të gjithë të barabartë përpara ligjit. Për arritjen e këtyre synimeve secili shtet vendos parimin e kontrollit dhe balancimit të pushteteve, ku pushtetit gjyqësor ka një rol të pazëvendësueshëm në ruajtjen e ekuilibrave ndërmjet pushteteve shtetërore. Drejtësia e një vendi mirëmbahet nga funksionimi i gjyqësorit të tij si dhe mbështetet nga puna profesionale dhe e paanshme e sistemit prokurorial. Republika e Kosovës synon të pastrojë sistemin e drejtësisë nga gjyqtarë dhe prokurorë të korruptuar, lidhur me politikën, të anshëm dhe jo profesional, andaj asaj i nevojitet realizimi i procesit të vetingut për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët e shtetit. Mos funksionimi i drejtësisë kosovare nuk mund të zgjidhet vetëm nga vetingu pasi që problematikat janë më të thella se kaq, andaj lypset edhe riorganizimi i drejtësisë përmes së cilit do të ndërtohej një sistem më i përshtatshëm për nevojat e Republikës së Kosovës. Domosdoshmëria për ta reformuar sistemin e drejtësisë në vend, paraqet nevojën që këto çështje sa më parë të jetësohen, ashtu që paraprakisht ato duhet të studiohen, analizohen dhe propozohen, në mënyrë që shteti i Kosovës të jetë i gatshëm për ti realizuar sapo të krijohen kushtet politike dhe juridike për një gjë të tillë.

Fjalë kyçe: reforma në drejtësi, vetingu, riorganizimi i drejtësisë, profesionalizmi, paanshmëria, drejtësia.